



PULSAR

Mbledhja V e Komunitetit të Praktikës për Raportimin Financiar (KPRF)

Vjenë, Austri, 21-22 nëntor 2019

Grupi i Punës i TCOP për Administrimin e Aktiveve: Raport përmbledhës

PEMPAL


Menaxhimi i Shpenzimeve Publike

Nxjerrja e mësimëve me ndihmën e kolegëve



Public Sector Accounting and Reporting Program

CO-FUNDED BY



Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Mbledhja e Grupit të Punës për Kontabilitetin dhe Raportimin në Sektorin Publik



2

Janë identifikuar tri tema të ndërlidhura me interes të veçantë për komunitetin e praktikës dhe më pas është krijuar një grup pune për secilën prej këtyre temave:

- **Standardet e kontabilitetit**
- **Konsolidimi i pasqyrave financiare**
- **Menaxhimi i aktiveve**

Grupi i Punës për Menaxhimin e Aktiveve



3

Shtetet pjesëmarrëse:

- Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Gjeorgjia, Kazakistani, Republika Kirgize, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Taxhikistani, Turqia dhe Ukraina
- Zoti **Mark Silins**, këshilltar në TCOP për menaxhimin e aktiveve publike: Prezantimi i metodikës, rekomandimeve, komenteve dhe shqyrtimi i çështjeve të veçanta

Grupi i Punës për Menaxhimin e Aktiveve



4

Gjatë fazës së procesit fillestar: Për ta kufizuar objektin e punës të grupit të punës brenda shqyrtimit të çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e aktiveve jo financiare (AJF) kryesisht të mbuluara nga SNKSP

17 – AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Objekti i menaxhimit të aktiveve




5

Aktivet jo financiare (AJF)

- Inventarët
- Aktivet historike
- Aktive të qëndrueshme (troje, ndërtesa dhe pajisje)
- Aktive infrastrukturore
- Aktive ushtarake
- Aktive afatgjata materiale të investuara
- Aktive biologjike dhe produkte bujqësore
- Aktive afatgjata jo-materiale



PESË HAPAT E KONTABILIZIMIT TË AJF-VE



Menaxhimi i aktiveve – probleme për t'u pasur parasysh



7

- Përcaktimi i jetës së dobishme të aktivitetit: Çdo vend ka faktorët e vet që ndikojnë, të cilët duhen pasur parasysh gjatë përcaktimit të jetës së dobishme për kategoritë e ndryshme të aktiveve
- Vlerësimet e pasurive të paluajtshme që ndodhen jashtë zonave kryesore të banuara ku shitblerjet e pasurive të paluajtshme nuk janë të shpeshta nuk mund të mbështeten në informacionet e tregut për të përcaktuar me saktësi vlerën e pasurisë në fjalë
- Aktivitetet me vlerë të vogël dhe me konsumim të shpejtë (VVKSH): Nevojiten vlera prag për kapitalizimin dhe politika përkatëse për të siguruar kategorizimin e duhur të aktiveve në aktive të kapitalizueshme dhe aktive që duhen futur të shpenzimet kur lindin
- Remonti kapital dhe riparimi me kosto të vogël
- Njohja e grupeve të caktuara të zërave me vlerë të vogël të cilat kanë rëndësi materiale të marra në total, kështu që duhen njohur si aktiv
- Zbërthimi në elemente të veçanta i aktiveve me vlerë të madhe, sidomos i aktiveve infrastrukturore
- Njohja e aktiveve infrastrukturore, ushtarake dhe kulturoro-historike

Përvoja e vendeve të veçanta



8

- **Kroacia:** Metodika e njohjes së AJF-ve është vënë në zbatim më 2013
- **Gjeorgjia:** Është zhvilluar një takim i PAA-së për të bërë një përmbledhje të shqetësimeve të lidhura me kontabilizimin dhe raportimin e aktiveve
- **Kazakistani:** Ky vend ka bërë progres të konsiderueshëm drejt vënies në zbatim të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara, përfshirë menaxhimin e AJF-ve
- Përvoja e këtyre tri vendeve konsiderohet si burim i vyer me interes për t'u parë në vijim

MBLEDHJA PLENARE – SHKURT 2014, TBILISI, GJEORGJI



9

- Të gjitha shteteve anëtare të TCOP-së iu shpërnda një pyetësor për të mbledhur informacione në lidhje me AJF-të
- U morën përgjigje nga 12 shtete (Bullgaria, Kroacia, Gjeorgjia, Kazakistani, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rusi, Serbia, Taxhikistani, Ukraina, Uzbekistani). Pyetësi u hartua në tri gjuhë – angleze, ruse dhe boshnjake – dhe përfshinte 23 pyetje.
- Zoti Mark Silins prezantoi gjetjet kryesore nga analiza e përgjigjeve të ardhura.
- Baza për zhvillimin e një metodika prototip dhe një udhëzimi mbi procedurën për secilin shtet (një prej detyrave kryesore të përfshira në planin e veprimit të grupit të punës të aktiveve).
- Pjesëmarrësit në pyetësor diskutuan për një sërë çështjesh të lidhura me menaxhimin e aktiveve, të cilat duheshin trajtuar si duhej në manual/udhëzues për të siguruar vijueshmërinë e sistemit kontabël. Shqetësimet e shprehura nga pjesëmarrësit në pyetësor nga disa shtete anëtare përfshinin sa vijon:

Pyetësoni për të mbledhur informacione në lidhje me AJF-të në të gjitha shtetet anëtare të TCOP-së



10

- AJF-të nuk vlerësohen me vlerën faktike për një sërë arsyes, ku përfshihet rivlerësimi joadekuat për zhvlerësim dhe mungesa e kontabilizimit të amortizimit
- Mungesa e raportimit të plotë për pronave publike në pasqyrat financiare të njësive ekonomike të sektorit publik
- Mungesa e një baze të njëtrajtshme informacioni (regjistri) në sektorin publik për të kontabilizuar AJF-të; nuk është përcaktuar asnjë regjistër për regjistrimin e aktiveve i cili të mund të përdoret nga njësitet ekonomike të sektorit publik
- Vlera e aktivitetit nuk përcaktohet në shumë raste kur aktivitetet publike transferohen midis njësive ekonomike të sektorit publik, çka kërkon shpenzime buxhetore shtesë për përcaktimin e kësaj vlere
- Disa shqetësime kishin të bënin me një qasje që duhet zbatuar për kontabilizimin e amortizimit: disa vende përdorin vetëm metodën lineare, e cila nuk është gjithmonë qasja optimale

Raporti mbi gjetjet e analizës së përgjigjeve të pyetësorit



11

- U ngrit një problem në lidhje me arsyeshmërinë e përdorimit paralelisht të dy metodave të ndryshme të vlerësimit të vlerës së aktiveve
- Çështja e identifikimit të grupeve të aktiveve që duhet të jenë objekt rivlerësimi
- Ka përplasje midis kontabilizimit të amortizimit të aktiveve për kohëzgjatjen e jetës së dobishme të aktivitetit dhe shumave standarde për amortizim që mund të përfshihen në shpenzimet e zbritshme për qëllime fiskale. Si mund të kapërcehen këto përplasje?
- Një çështje tjetër është veçimi i kostove të remontit/riparimit në shpenzime kapitale dhe shpenzime shfrytëzimi brenda një projekti sepse zakonisht ka vetëm një zë buxheti për kostot e riparimit

Raporti mbi gjetjet e analizës së përgjigjeve të pyetësorit



12

- Si duhet t'i vlerësojë përfitimet ekonomike të aktivitetit njësisë ekonomike e sektorit publik? Si duhen kryer rivlerësimet (për shembull, në rastin e një aktivi të patrupëzuar që është faqe interneti)?
- Metodatat e rivlerësimit të aktiveve afatgjata
- Informacioni dëshmuar që shërben si bazë mbështetëse për vlerën e dalë nga rivlerësimi i aktivitetit
- Strategjitë për të punuar me regjistrimet e bëra në një regjistër të përgjithshëm të centralizuar të cilin e mban Thesari

Raporti mbi gjetjet e analizës së përgjigjeve të pyetësorit



13

- Çështja e shpërndarjes së të drejtave për pasur në zotërim aktivet mes njësive ekonomike në nivele të ndryshme të qeverisjes publike
- Kush e kontabilizon tokën shtetërore në rastin kur shteti është palë e cila gëzon përfitimet ekonomike të gjeneruara nga toka?
- A ka një vlerë prag për njohjen e aktiveve jo financiare?
- Si duhet të vlerësohet vlera e aktiveve të patrupëzuara?
- A është e nevojshme të përcaktohet një klasë e veçantë aktivesh për të kontabilizuar objektet dhe pajisjet ushtarake?

Raporti mbi gjetjet e analizës së përgjigjeve të pyetësorit: Rekomandimet kryesore dhe veprimet në ndjekje të tyre



- Kur shtetet janë përgjigjur se bëjnë inventar fizik në mënyrë të rregullt, pa e specifikuar shpeshtësinë e kryerjes së inventarit, do të ishte e arsyeshme të sqarohet nëse inventari bëhet çdo vit apo me tjetër frekuencë.
- Për të hartuar një grup klasash standarde për AJF-të si bazë e mundshme që të qëndrojë në bazë të politikave dhe procedurave kontabël model.
- Një diskutim i specializuar për shkallët dhe metodat e amortizimit mund të ishte i arsyeshëm si veprim pasues për grupin e punës; programi i këtij veprimi mund të përfshinte edhe raportin e Serbisë për zbatimin e metodikës së çregjistrimit të vlerës kontabël të përmendur në përgjigjet e Serbisë në pyetësor.
- Një mënyrë si mund të bëhet do të ishte një kërkesë drejtuar çdo vendi për të zhvilluar një seksion udhëzues që mbulon një prej drejtimeve për politikën kontabël për AJF-të dhe të gjitha procedurat e detyrueshme ndihmëse, dhe pastaj për t'i përdorur këto seksione të përdorura nga vendet e veçanta si bazë për hartimin e një pakete të plotë metodash dhe qasjesh standarde si udhëzues të përgjithshëm.

Raporti mbi gjetjet e analizës së përgjigjeve të pyetësorit: Rekomandimet kryesore dhe veprimet e ardhshme



- Diskutimi mund të vijonte lidhur me vlerat prag të aktiveve që përdoren për të vendosur nëse është e mundshme të arrihet një metodikë e përbashkët ose një qasje e përbashkët për përgatitjen e manualit.
- Do të ishte e dobishme të vijohej diskutimi lidhur me mbajtjen e regjistrave të aktiveve, përfshirë proceset ekzistuese për menaxhimin e aktiveve dhe bërjen e korigjimeve në të dhënat kontabël të regjistrit në funksion të raportimit financiar, si edhe klasat dhe llojet e aktiveve të trupëzuara jo të përfshira në regjistër. Me interes do të ishte edhe të kontrollohej deri ku veprimet financiare raportohen në regjistër ose lidhen me librin e madh në sistemin kontabël. Në mënyrë ideale, regjistri i aktiveve do të duhej të ishte regjistër ndihmës për librin e madh të sistemit kontabël.
- Do të ishte e arsyeshme të kontrollohej në rastin e vendeve që përmendin në përgjigjet e tyre regjistrat e dyfishtë—në nivel të centralizuar dhe në ministritë përkatëse të linjës—nëse këta regjistra janë plotësisht të veçuar dhe nëse përdoren për të regjistruar të njëjtin informacion apo të kontrolluar lloje të ndryshme aktivesh (për shembull, kur toka dhe ndërtesat regjistrohen në regjistrin qendror dhe aktivet operative regjistrohen në regjistrat e mbajtur nga ministritë përkatëse të linjës).

Raporti mbi gjetjet e analizës së përgjigjeve të pyetësorit: Rekomandimet kryesore dhe veprimet e ardhshme



- Do të ishte e arsyeshme të shqyrtoheshin shembuj të metodave që përdorin vlera prag të aktiveve dhe procedurave për përfshirjen në një udhëzues standard metodik.
- Për të zhvilluar një rast studimor mbi zbatimin faktik të një metode për rivlerësimin e aktiveve (dhe një shqyrtim për shenja amortizimi/zhvlerësimi).

Lista standarde e klasave të aktiveve (në bazë të përgjigjeve të pyetësorit)



17

- Toka dhe troje
- Ndërtesa banimi
- *Ndërtesa jo banimi*
- Struktura
- Pajisje transporti
- Të tjera impiante dhe pajisje
- Aktive të nëntokës
- Aktive natyrore të kultivuara
- Aktive të tjera natyrore
- Inventar në magazinë
- Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara
- Aktive afatgjata jo-materiale jo të prodhuara
- Aktivitet e trupëzuara
- Objekte kulturore dhe të trashëgimisë kulturore

Struktura e përafërt e udhëzuesit për politikat e kontabilizimit të aktiveve



- Kuadri ligjor dhe rregullator: baza janë aktet ligjore dhe standardet përkatëse, përfshirë GFSM2001/2014.
- Deklaratë mbi faktin nëse këto metodike ose udhëzime ose të dyja së bashku janë të detyrueshme (p.sh., nëse lejohet të merret vendim në nivel lokal ku një metodikë ose procedurë e caktuar nuk e trajton një situatë të veçantë). Kujt ia drejton pyetjet kur nuk je i sigurt se si duhet proceduar në një situatë të veçantë (për shembull, Drejtoria e Audituesit të Përgjithshëm, Drejtoria e Politikave Kontabël).
- Përkufizimi i aktiveve jo financiare (mund të jepet në një format më të përafërt me SNKSP-të, si: Aktive afatgjata materiale, Aktive afatgjata jo-materiale).
- Gama e aktiveve që mbulon ky udhëzues (plani kontabël mund të jetë një pikënisje e mirë). Disa vende mund të vendosin të mos përfshijnë disa aktive të caktuar në masat organizative të periudhës kalimtare ose të zbatojnë një metodikë të veçantë trajtimi për aktive të tilla (p.sh., toka dhe troje, aktive të nëntokës).
- Administrimi i AJF-ve: Kjo çështje ka rëndësi të veçantë kur disa aktive (p.sh., toka, troje dhe ndërtesa) administrohen në mënyrë të centralizuar dhe disa lloje të tjera aktivesh nga ministritë përkatëse të linjës. Ky kapitull duhet të sqarojë edhe se cili institucion/autoritet shtetëror administron dhe kontabilizon cilat aktive.
- Udhëzimet për mbajtjen e regjistrit/regjistrave të aktiveve dhe konstatimi i tepricave të çeljes:

a. Shtesa të reja

Struktura e përafërt e udhëzuesit për politikat e kontabilizimit të aktiveve



19

- Marrjet në pronësi
 - Projektet e ndërtimit, përfshirë trajtimin e ndërtimit në proces në mbyllje të periudhës kontabël
 - Transferimet, përfshirë vlerësimin e aktiveve të kaluara që nuk janë të reja
- b. Të dhënat që duhen përfshirë në regjistrin e aktiveve
- c. Amortizimi (do të përfshihet një tabelë për metodën e propozuar të amortizimit dhe jetën e dobishme për klasat/nënklasat e ndryshme të aktiveve
- d. Rivlerësimi
- *Udhëzimet e përgjithshme*
 - *Rivlerësimi i aktiveve: Çfarë ndodh kur shkalla standarde e amortizimit bie ndesh me kushtet e jetës së dobishme?*
- e. Zhvlerësimi i përhershëm
- f. Heqja nga pronësia
- *Shitja*
 - *Transferimi*
 - *Fshirja (kalimi si shpenzim) i aktiveve në përfundim të jetës së dobishme ose i aktiveve plotësisht të zhvlerësuara*

Struktura e përafërt e udhëzuesit për politikat e kontabilizimit të aktiveve



VIII.	Kryerja vjetore e inventarit a. Udhëzimet për bërjen e inventarit b. Shpeshtësia (mund të jetë e ndryshme në varësi të llojit të aktivitetit) c. Çështjet që duhen pasqyruar në raport (çështje sistematike, zhvlerësimi i të gjithë klasës së aktiveve, humbjet, rastet e mashtrimit dhe/ose keqpërdorimit)
IX.	Vlerat prag për njohjen e aktiveve jo financiare a. Përse nevojiten vlerat prag? Pasojat kontabël dhe buxhetore të kalimit në shpenzime të llojeve të caktuara të aktiveve b. Aktivitetet e reja c. Aktivitetet e krijuara nga shteti d. Remonti kapital e. Grupimi i aktiveve (me pasojën që mund të bëhen aktive të trupëzuara)
X.	Politikat e rivlerësimit
XI.	Politikat e shuarjes së vlerës
XII.	Politikat për ndarjen në komponentë
XIII.	Fshirjet dhe humbjet që duhen reflektuar në raport dhe shqyrtuar në mënyrë të pavarur për ekzistencën e problemeve në sistem ose të shkeljes së detyrës
XIV.	Aktivitetet afatgjata jo-materiale
XV.	Pajisjet ushtarake
XVI.	Inventar në magazinë

Produktet e grupit të punës

21

- Raporti mbi rezultatet dhe gjetjet e analizës së përgjigjeve të pyetësorit

<http://www.pempal.org/event/eventitem/read/106/430>

- Tabela me një listë të përafërt standarde të klasave të aktiveve
- Plani udhëzues për përdorimin
- Udhëzuesi i përgatitur në Kazakistan

http://www.pempal.org/data/upload/files/2014/11/paa_draft-guidance-on-publicassets_rus.pdf

- Raporti PAA për Gjeorgjinë

http://www.pempal.org/data/upload/files/2014/11/paa_report-support-tomonitoring-of-pfm-reforms-support-programme-georgia- rus.pdf

- Dokumente model (shtetet anëtare të OECD-së: Australia dhe Kanadaja) mbi politikat kontabël për aktivet:

<http://www.finance.gov.au/publications/finance-ministers-orders/> <http://www.tbs-sct.gc.ca/pol/index-eng.aspx>



FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!

Zonja ANGELA VORONIN, Drejtoreshë e Thesarit të Shtetit,
Ministria e Financave e Republikës së Moldavisë; Kryetare e KPTH,
PEMPAL